



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 324/17 Prot.

Pogradec, më 02.02.2026

VENDIM

NR. 15, DATË 29.01.2026
PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMEVE DHE TË
PARASHIKIMEVE AFATMESME TË TË ARDHURAVE NË BASHKINË
POGRADEC
PËR VITIN 2027-2029

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Të miratojë raportit e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë
Pogradec për vitet 2027-2029, sipas dokumentit pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatim e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

KRYETARE E KËSHILLI
Manjola KAMOLLI

1. Miratuar me 22 vota

2. Vota Pro 22

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 29.01.2026



RAPORT PËR VLERËSIMIN DHE PARASHIKIMIN AFATMESËM TË TË ARDHURAVE NË BASHKINË POGRADEÇ PËR VITET 2027-2029

Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi i parashikimit afatmesëm të të ardhurave për vitet 2027-2029.

- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
- Ligjit Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.
- Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.
- Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar.
- VKM nr. 132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa" e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", i ndryshuar.
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar,

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave janë mbështetur në nenin 34 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, që përcakton shprehimisht:

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve

1. Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:

- a) dy vitet para vitit buxhetor;
- b) vitin buxhetor;
- c) tre vitet e ardhshme buxhetore.

2. Në këtë raport përfshihen:

- a) metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave;
- b) analiza të efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre ekzistuese;
- c) analiza e risqeve dhe masave për përbalimin e tyre.



METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR PARASHIKIMIN AFATMESËM TË TË ARDHURAVE 2027-2029.

Politikat tatimore dhe parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat në Bashkinë Pogradec, është mbështetur:

Në nivelet e aplikueshme të taksave dhe tarifave vendore të miratuara si në legjislacionin tatimor në fuqi, ashtu dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 133, datë 11.12.2023 për "Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec", i ndryshuar, të cilat përcaktojnë llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajojnë çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcaktojnë qartë edhe administrimin e tyre duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Në realizimet faktike të të ardhurave për periudhën paraardhëse dhe realizimin e vitit 2024.

Në përlllogaritjet e kapaciteteve reale të taksave dhe tarifave nëpërmjet zgjerimit të bazës së taksapaguesve dhe saktësimit të të dhënave për të cilat janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, pronarë pasurish, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të taksave dhe tarifave sipas llojeve.

Në parashikimin e mbledhjes së detyrimeve debitoare të 18 muajve të fundit referuar legjislacionit në fuqi, duke zbatuar me përpikmëri të gjitha hapat, procedurat dhe afatet e parashikuara si dhe duke bashkëpunuar ngushtë me aktorët e tjerë për vijimësinë dhe efektivitetin e këtyre masave.

Në parashikimin e të ardhurave që mbledhen nga agjentët tatimorë duke kërkuar, rritur dhe forcuar më tepër kontrollin mbi ta por dhe mënyrën e rakordimit për taksat apo tarifat që këta të fundit mbledhin për llogari të Bashkisë Pogradec.

Në parashikimin e të ardhurave që mbledhen nga drejtoritë e Bashkisë.

Në ecurinë e realizimit të të ardhurave për çdo taksë dhe tarifë si dhe duke analizuar faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

Në forcimin e kapaciteteve administruese.

Në lehtësimin e procedurave dhe përmirësimin e klimës së marrëdhënieve me taksapaguesit.

Në aplikimin e iniciativave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, referuar legjislacionit në fuqi.

Ecuria e të ardhurave dhe parashikimi për tre vitet e tjera buxhetore:

	Fakt 2024	Plani 2025	Fakt 2025	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
YË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	473,777,668	697,500,270	528,468,081	805,386,200	808,483,031	810,127,688	811,780,043
YË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE	132,837,131	301,425,887	152,186,907	433,453,200	435,431,016	435,951,063	436,473,185



Handwritten signature

Taksa vendore mbi biznesin e vogël	676,790	400,000	451,868	400,000	600,000	700,000	800,000
Taksa mbi pavarinë e pajisjeve	80,492,948	94,107,647	86,778,419	86,253,200	88,031,016	88,451,063	88,873,185
Taksa mbi ndërtuesin	73,332,795	83,339,447	78,578,844	78,000,000	79,751,550	80,150,308	80,551,059
Taksa mbi ndërtuesin familje	48,832,795	51,361,550	49,798,344	50,000,000	51,611,550	51,869,608	52,128,956
Taksa mbi ndërtuesin biznes	24,500,000	31,977,897	28,780,500	28,000,000	28,140,000	28,280,700	28,422,104
Taksa mbi taksa bujqësore	2,777,928	5,515,000	3,073,632	3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000
Taksa mbi truallin	4,382,225	5,253,200	5,125,943	5,253,200	5,279,466	5,300,755	5,322,126
Taksa mbi truallin familje	1,168,274	1,021,600	921,426	1,021,600	1,026,708	1,026,734	1,026,734
Taksa mbi truallin biznes	3,213,951	4,231,600	4,204,517	4,231,600	4,252,758	4,274,022	4,295,392
Taksa vendore në shërbimin hotelier	8,984,805	7,620,000	8,651,927	9,000,000	9,000,000	9,000,000	9,000,000
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	34,731,385	192,380,000	48,971,298	330,000,000	330,000,000	330,000,000	330,000,000
Taksa e tabelës	7,951,203	6,918,240	6,333,395	7,800,000	7,800,000	7,800,000	7,800,000
Tabele për qelime identifikimi	3,121,879	2,168,740	1,506,222	3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000
Tabele për qelime reklamimi	4,829,324	4,749,500	4,827,173	4,800,000	4,800,000	4,800,000	4,800,000
TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	60,776,586	49,444,600	63,129,842	67,700,000	67,700,000	67,700,000	67,700,000
Taksa mbi kullimin e të drejtës së pronësisë / pavaritë e pajisjeve	2,985,156	2,500,000	5,169,986	4,500,000	4,500,000	4,500,000	4,500,000
Taksa rjetore për qarkullimin e njetëve të përdorura	30,250,235	24,000,000	33,491,320	33,000,000	33,000,000	33,000,000	33,000,000
Taksa e rentës minerare 5%	217,924	200,000	184,971	200,000	200,000	200,000	200,000
Taksa mbi të ardhurat personale 2%	27,323,271	22,744,600	24,283,565	30,000,000	30,000,000	30,000,000	30,000,000
TE ARDHURA NGA TARIFA VENDORE	252,089,385	314,127,999	261,199,306	266,063,000	267,182,015	268,306,625	269,436,888
Tarifa me memachimin të mbetjeve	111,630,747	155,230,606	116,702,827	122,720,000	123,333,600	123,950,268	124,570,019
Tarifa e pavaritë për familjet	60,430,747	81,739,980	57,305,437	63,000,000	63,315,000	63,631,575	63,949,733
Tarifa e pavaritë për institucionet	720,000	720,000	720,000	720,000	723,600	727,218	730,854
Tarifa e pavaritë për biznesin	50,480,000	72,770,626	58,677,390	59,000,000	59,295,000	59,591,475	59,889,432
Tarifa për ndriçimin publik	36,946,740	41,518,500	31,028,603	32,723,000	32,886,615	33,051,048	33,216,303
Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	29,973,940	31,932,500	23,672,075	25,000,000	25,125,000	25,250,625	25,376,878
Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	23,000	23,000	23,000	23,000	23,115	23,231	23,347
Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	6,949,800	9,563,000	7,333,528	7,700,000	7,738,500	7,777,193	7,816,078
Tarifa për gjelbërimin	55,520,040	72,684,293	57,072,317	58,360,000	58,651,800	58,945,059	59,239,784
Tarifa për gjelbërimin nga familjet	29,920,040	37,950,000	28,985,092	30,000,000	30,150,000	30,300,750	30,452,754
Tarifa për gjelbërimin nga institucionet	360,000	360,000	360,000	360,000	361,800	363,609	365,427
Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	25,240,000	34,374,293	27,727,225	28,000,000	28,140,000	28,280,300	28,422,104

Tarife per mirembajtjen e varrezave	10,355,464	12,744,600	9,048,666	10,000,000	10,050,000	10,100,250	10,150,751
Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	37,636,394	31,950,000	40,346,893	42,260,000	42,260,000	42,260,000	42,260,000
Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	1,696,621	1,000,000	1,211,150	1,700,000	1,700,000	1,700,000	1,700,000
Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	17,371,397	17,000,000	20,801,442	21,000,000	21,000,000	21,000,000	21,000,000
Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit	488,079	500,000	451,736	700,000	700,000	700,000	700,000
Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe vendparkime publike	546,200						
Tarifa për pyejt dhe kullatat	987,900	1,000,000	358,024	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000
Tarifa për shërbimet shpesh nga zjarrëfiksjë MNZ	756,730	400,000	488,298	760,000	760,000	760,000	760,000
Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave	13,806,134	10,000,000	13,911,659	15,000,000	15,000,000	15,000,000	15,000,000
Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	1,983,333	2,050,000	1,912,500	2,100,000	2,100,000	2,100,000	2,100,000
Tarifa për dru zjarri			728,100				
Tarifa të tjera			483,984				
Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	16,199,288	11,374,000	11,383,296	12,000,000	12,000,000	12,000,000	12,000,000
Qendra kulturore e fëmijëve		380,000					
Pallati i sportit		350,000					
Cerdhët & Kopshtet	7,858,037	5,544,000	8,724,780	9,000,000	9,000,000	9,000,000	9,000,000
Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime		500,000					
Ndërmarrja NMI	2,569,036	4,600,000	2,658,516	3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000
te tjera tarifa							
Te ardhura nga shitja	5,772,215						
TË ARDHURAT E TJERA	11,875,278	21,127,784	48,568,730	26,170,000	26,170,000	26,170,000	26,170,000
Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	9,298,679	17,127,784	10,743,092	21,000,000	21,000,000	21,000,000	21,000,000
Kundërvajtjet administrative (Gjohat)	976,305	3,000,000	4,335,069	4,000,000	4,000,000	4,000,000	4,000,000
Kontribut subjekte			14,906,128	14,906,128			
Grafitë nga ndihma ndërkombëtare	433,736		17,070,374				
Te tjera (ndikim në mjedis)	1,166,558	1,000,000	1,514,067	1,170,000	1,170,000	1,170,000	1,170,000
TË ARDHURA NGA BËRIMET E VETA	473,777,668	697,500,270	528,468,081	805,386,200	808,483,031	810,127,688	811,780,043



Të ardhurat e veta vendore:

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave të veta, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar. Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përberëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm. Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Pogradec referuar Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 133, datë 11.12.2023 për "Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec", i ndryshuar, të cilat përcaktojnë llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Paketa fiskale përcakton:

Kornizën ligjore për përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese;
Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësi për çdo taksë dhe tarifë.
Përcaktimin e qartë dhe ndarjen e taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë është detajuar duke patur në konsideratë elementet:

- Klasifikimi i biznesit, qarkullimi vjetor, lloj i aktivitetit.
- Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj.

Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon, përcaktimin dhe detajimin në kategori, unifikimin e kategorive për të gjitha taksat, përcaktimin e bazës së taksueshme dhe aplikimin e kufijve që përcakton ligji.

Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia, përcaktimin dhe detajimin në kategori, unifikimin e kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimin e nivelit të tarifave mbështetur në raportet bazë të vlerësimit të kostos së shërbimit për të cilin vendosen (shërbimi i pastrimit, shërbimi i ndriçimit rugor, shërbimi i gjelbërimit dhe shërbimi mirëmbajtje varrezash.

Aplikimin e iniciativave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, referuar legjislacionit në fuqi.

Të ardhurat nga burimet lokale dhe qëndrore:

<i>Burimet e financimit</i>	<i>Fakti 2024</i>	<i>Fakti 2025</i>	<i>Plani 2026</i>	<i>Plani 2027</i>	<i>Plani 2028</i>	<i>Plani 2029</i>
<i>Të ardhura lokale</i>	<i>473,732,681</i>	<i>528,468,081</i>	<i>805,386,200</i>	<i>808,483,031</i>	<i>810,127,688</i>	<i>811,780,043</i>
<i>Transferita të pakushtëzuara të përgjithshme</i>	<i>576,703,000</i>	<i>507,305,000</i>	<i>628,419,000</i>	<i>650,656,000</i>	<i>674,619,000</i>	<i>674,619,000</i>
<i>Transferita të pakushtëzuara sektoriale</i>	<i>231,615,000</i>	<i>326,166,000</i>	<i>350,697,000</i>	<i>350,697,000</i>	<i>350,697,000</i>	<i>350,697,000</i>
<i>Të ardhura gjithësej</i>	<i>1,282,050,681</i>	<i>1,361,939,081</i>	<i>1,784,502,200</i>	<i>1,809,836,031</i>	<i>1,835,443,688</i>	<i>1,837,096,043</i>

Të ardhurat nga burimet të veta vendore sipas llojit:

Të ardhurat nga burimet e veta vendore, përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifatat vendore dhe të ardhurat nga taksat e ndara. Tabela me % që zë të ardhurat nga burimet e veta.

Burimet e financimit	Fakt 2024	Plani 2025	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
Të ardhurat nga taksat vendore	29	44	54	54	54	54
Të ardhurat nga tarifatat vendore	54	46	34	34	34	34
Të ardhurat nga taksat e ndara	13	7	8	8	8	8
Të ardhurat nga tarifa të tjera (qira, gjoja, ndikimi)	4	3	4	4	4	4
Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	71 % e planit	60 % e planit	45 % e planit	46 % e planit	47 % e planit	48 % e planit
Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit	11 % e planit	30 % e planit	44 % e planit	44 % e planit	44 % e planit	44 % e planit
Nga tarifatat e tjera planifikohen të ardhurat	5 % e planit	3 % e planit	11 % e planit	12 % e planit	13 % e planit	14 % e planit

Të ardhurat nga taksat vendore zënë 54 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të mbledhen për vitin 2026,

Të ardhurat nga tarifatat vendore zënë 34 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen për vitin 2026.

Të ardhurat nga taksat e ndara zënë 8 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen për vitin 2026.

Të ardhurat nga tarifa të tjera (qira, gjoja, ndikimi në mjedis) zënë 4 % të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen për vitin 2026.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore planifikohet të mbledhë 46 % të parashikimit të planit. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit planifikon të mbledhë 30% të parashikimit.

Nga taksat e ndara planifikohet të arkëtohen 8 % të të ardhurave të parashikuara për t'u arkëtuar në vitin 2026.

Nga tarifatat e tjera planifikohet të arkëtohen 4 % të të ardhurave të parashikuara për t'u arkëtuar në vitin 2026.

Të ardhurat nga burimet të veta vendore Buxheti afatmesëm 2027-2029

Burimet e financimit	Fakt 2024	Fakt 2025	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
Të ardhura nga taksat lokale	132,837,131	144,186,907	433,453,200	435,431,016	435,951,063	436,473,185

Të ardhura nga tarifa vendore	252,089,385	261,199,306	266,063,000	267,182,015	268,306,625	269,436,858
Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit ,NMI	16,199,288	11,383,296	12,000,000	12,000,000	12,000,000	12,000,000
Të ardhurat e tjera qira,gjebra,etj	11,875,278	48,568,730	26,170,000	26,170,000	26,170,000	26,170,000
Të ardhura nga burimet e veta	413,001,082	465,338,239	737,686,200	740,783,031	742,427,688	744,080,043

Tabela mbi parashikimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore si dhe burimet e tjera që do të përbëjnë buxhetin afatmesëm të të ardhurave në Bashkinë Pogradec:

	Fakt 2024	Fakt 2025	Plani 2026	Plani 2027	Plani 2028	Plani 2029
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	473,777,668	528,468,081	805,386,200	808,483,031	810,127,658	811,780,043
TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE	132,837,131	152,186,907	433,453,200	435,431,016	435,951,063	436,473,185
Taksa vendore mbi biznesin e vogël	676,790	451,868	400,000	600,000	700,000	800,000
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	80,492,948	86,778,419	86,253,200	88,031,016	88,451,063	88,873,185
Taksa mbi ndërtuesin	73,332,795	78,578,844	78,000,000	79,751,550	80,150,308	80,551,059
Taksa mbi ndërtuesin familje	48,832,795	49,798,344	50,000,000	51,611,550	51,869,608	52,128,956
Taksa mbi ndërtuesin biznes	24,500,000	28,780,500	28,000,000	28,140,000	28,280,700	28,422,104
Taksa mbi tokën bujqësore	2,777,928	3,073,632	3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000
Taksa mbi truallin	4,382,225	5,125,943	5,253,200	5,279,466	5,300,755	5,322,126
Taksa mbi truallin familje	1,168,274	921,426	1,021,600	1,026,708	1,026,734	1,026,734
Taksa mbi truallin biznes	3,213,951	4,204,517	4,231,600	4,252,758	4,274,022	4,295,392
Taksa vendore në shërbimin hotelier	8,984,805	8,651,927	9,000,000	9,000,000	9,000,000	9,000,000
Taksa e ndërkult në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	34,731,385	48,971,298	330,000,000	330,000,000	330,000,000	330,000,000
Taksa e tabelës	7,951,203	6,333,395	7,800,000	7,800,000	7,800,000	7,800,000
Tabele per gellime identifikimi	3,121,829	1,506,222	3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000
Tabele per gellime reklamimi	4,829,324	4,827,173	4,800,000	4,800,000	4,800,000	4,800,000



TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	60,776,586	63,129,842	67,700,000	67,700,000	67,700,000	67,700,000
Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	2,985,156	5,169,986	4,500,000	4,500,000	4,500,000	4,500,000
Taksa vjetore për qarkullimin e njetëve të përdorura	30,250,235	33,491,320	33,000,000	33,000,000	33,000,000	33,000,000
Taksa e rentës minierare 5%	217,924	184,971	200,000	200,000	200,000	200,000
Taksa mbi të ardhurat personale 2%	27,323,271	24,283,565	30,000,000	30,000,000	30,000,000	30,000,000
TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE	252,089,385	261,199,306	266,063,000	267,182,015	268,306,625	269,436,858
Tarifa me menaxhimin të ujërave	111,630,747	116,702,827	122,720,000	123,333,600	123,950,268	124,570,019
Tarifa e pastrimit për familjet	60,430,747	57,305,437	63,000,000	63,315,000	63,631,575	63,949,733
Tarifa e pastrimit për institucionet	720,000	720,000	720,000	723,600	727,218	730,834
Tarifa e pastrimit për biznesin	50,480,000	58,677,390	59,000,000	59,295,000	59,591,475	59,889,437
Tarifa për udhëtimin publik	36,946,740	31,028,603	32,723,000	32,886,615	33,051,048	33,216,303
Tarifa për udhëtimin publik nga familjet	29,973,940	23,672,073	25,000,000	25,125,000	25,250,625	25,376,878
Tarifa për udhëtimin publik nga institucionet	23,000	23,000	23,000	23,115	23,231	23,347
Tarifa për udhëtimin publik nga biznesi	6,949,800	7,333,528	7,700,000	7,738,500	7,777,193	7,816,078
Tarifa për gjelbërimin	55,520,040	57,072,317	58,360,000	58,651,800	58,945,059	59,239,784
Tarifa për gjelbërimin nga familjet	29,920,040	28,985,092	30,000,000	30,150,000	30,300,750	30,452,254
Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	360,000	360,000	360,000	361,800	363,609	365,427
Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	25,240,000	27,727,225	28,000,000	28,140,000	28,280,700	28,422,104
Tarifa për mbledhjen e vorezave	10,355,464	9,048,666	10,000,000	10,050,000	10,100,250	10,150,751
Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	37,636,394	40,346,893	42,260,000	42,260,000	42,260,000	42,260,000
Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	1,696,621	1,211,150	1,700,000	1,700,000	1,700,000	1,700,000
Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	17,371,397	20,801,442	21,000,000	21,000,000	21,000,000	21,000,000
Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit	488,079	451,736	700,000	700,000	700,000	700,000
Tarifa e parkimit për njetet e licencuara dhe vendparkime publike	546,200					
Tarifa për pyejt dhe kallotat	987,900	358,024	1,000,000	1,000,000	1,000,000	1,000,000
Tarifa për shërbimet shëtitore nga zjarretëfikja MINZ	756,730	488,298	760,000	760,000	760,000	760,000
Tarifa për zëmin dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave	13,806,134	13,911,639	15,000,000	15,000,000	15,000,000	15,000,000
Tarifa për linjat ajrore dhe nëtoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	1,983,333	1,912,500	2,100,000	2,100,000	2,100,000	2,100,000
Tarifa për dru zjarri		728,100				
Tarifa të tjera		483,984				



Në Njësine Administrative Velçan të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2026, përlllogariten në vlerën 4,690,599 lekë konkretisht: Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2026, planifikohen në vlerën 4,564,599 lekë.

Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis pritet në vlerën 126,000 lekë.

Në Njësine Administrative Trebinjë të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2026, përlllogariten në vlerën 3,428,841 lekë, konkretisht:

Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2026, në Njësine Administrative Trebinjë planifikohen në vlerën 3,372,841 lekë.

Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis pritet në vlerën 56,000 lekë.

Në Njësine Administrative Proptisht të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2026, përlllogariten në vlerën 5,943,500 lekë, konkretisht:

Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2026, në Njësine Administrative Proptisht planifikohen në vlerën 5,803,500 lekë.

Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis në Njësine Administrative Proptisht pritet në vlerën 140,000 lekë.

Në Njësine Administrative Dardhas të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2026, përlllogariten në vlerën 633,112 lekë, konkretisht:

Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2026, në Njësine Administrative Proptisht planifikohen në vlerën 633,112 lekë.

Në Njësine Administrative Çërravë të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2026, përlllogariten në vlerën 451,948 lekë, konkretisht:

Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2026, në Njësine Administrative Çërravë planifikohen në vlerën 347,948lekë.

Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis në Njësine Administrative Çërravë pritet në vlerën 104,000 lekë.

Në Njësine Administrative Çërravë pritet të arkëtohen nga subjektet debitorë për taksën e ndikimit në mjedis nga 7 subjekte vlera prej 20,000 lekësh.

Në Njësine Administrative Udënisht të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2026, përlllogariten në vlerën 451,948 lekë, konkretisht:

Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2026, në Njësine Administrative Udënisht planifikohen në vlerën 347,948 lekë.

Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis në Njësine Administrative Udënisht pritet në vlerën 104,000 lekë.

NëNjësine Administrative Udënisht pritet të arkëtohen nga subjektet debitorëpërtaksën e ndikimit në mjedis nga 5 subjekte vlera prej 20,000 lekësh.



Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	16,199,288	11,383,296	12,000,000	12,000,000	12,000,000	12,000,000
Qendra kulturore o fëmijëve						
Pallati i sportit						
Çerdhet & Kopshtet	7,858,037	8,724,780	9,000,000	9,000,000	9,000,000	9,000,000
Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime						
Ndërmarrja NMI	2,569,036	2,658,516	3,000,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000
te tjera tarifa						
Te ardhura nga shitja	5,772,215					
TË ARDHURAT E TJERA	11,875,278	48,568,730	26,170,000	26,170,000	26,170,000	26,170,000
Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	9,298,679	10,743,092	21,000,000	21,000,000	21,000,000	21,000,000
Kundrvajtjet administrative (Gjobat)	976,305	4,335,069	4,000,000	4,000,000	4,000,000	4,000,000
Kontribut subjekte		14,906,128	14,906,128			
Grante nga ndihma ndërkombëtare	433,736	17,070,374				
Te tjera (ndikim në mjedis)	1,165,558	1,514,067	1,170,000	1,170,000	1,170,000	1,170,000
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	473,777,668	528,468,081	805,386,200	808,483,031	810,127,688	811,780,043
Transferi te pakushitësnara përgjithshme	576,703,000	507,305,000	628,419,000	808,483,031	674,619,000	674,619,000
Transferi te pakushitësnara sektoriale	231,615,000	326,166,000	350,697,000	650,656,000	350,697,000	350,697,000
Te ardhura gjithësej	1,282,050,681	1,361,939,081	1,784,502,200	1,809,836,031	1,835,443,688	1,837,096,043

Kapacitetet fiskale të taksapaguesve:

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli i Bashkisë.

Në total numri i taksapaguesve është parashikuar rreth 26,097 nga të cilët: 24121 familje, 1953 biznese dhe Institucione 23



Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet.

Taksapaguesit familjarë:

<i>Bashkia familje</i>	<i>gjendje civile</i>	<i>census</i>	<i>Ndihme ekonomike</i>	<i>Pensionist</i>	<i>Lehtësi me</i>	<i>kryefamiljare</i>	<i>Familjet që paguajnë te plota detyrime</i>
<i>NJA Pogradec</i>	<i>14,167</i>	<i>11,500</i>	<i>471</i>	<i>1541</i>	<i>2012</i>	<i>402</i>	<i>9,086</i>
<i>NJA Bucimas</i>	<i>6,554</i>	<i>4,539</i>	<i>570</i>	<i>411</i>	<i>981</i>	<i>190</i>	<i>3,368</i>
<i>NJA Udenisht</i>	<i>2,722</i>	<i>2,000</i>	<i>201</i>	<i>198</i>	<i>399</i>	<i>20</i>	<i>1,581</i>
<i>NJA Cerrave</i>	<i>3,214</i>	<i>2,500</i>	<i>402</i>	<i>86</i>	<i>488</i>	<i>12</i>	<i>2,000</i>
<i>NJA Dardhas</i>	<i>1,198</i>	<i>638</i>	<i>394</i>	<i>50</i>	<i>444</i>	<i>4</i>	<i>190</i>
<i>NJA Proptisht</i>	<i>2,017</i>	<i>1,351</i>	<i>223</i>	<i>50</i>	<i>273</i>	<i>13</i>	<i>1,065</i>
<i>NJA Velcan</i>	<i>1,030</i>	<i>785</i>	<i>383</i>	<i>50</i>	<i>433</i>	<i>3</i>	<i>349</i>
<i>NJA Trebinje</i>	<i>1,007</i>	<i>793</i>	<i>214</i>	<i>50</i>	<i>264</i>	<i>5</i>	<i>524</i>
<i>TOTAL</i>	<i>31,909</i>	<i>24,106</i>	<i>2858</i>	<i>2436</i>	<i>5294</i>	<i>649</i>	<i>18,163</i>

Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Pogradec është 31,909 familje . Nga këto familje taksapagues janë 18163 prej të cilave, 5943 familje me ndihmë ekonomike, invalidë dhe pensionistë përfitojnë përjashtime ose lehtësime sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 133, datë 11.12.2023 për "Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec", i ndryshuar.

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafruar kapaciteteve reale të arkëtimeve në vitet e kaluara sipas familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e zonave me numrin e familjeve sipas Regjistrave në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore. Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet që janë përfituese të ndihmës ekonomike, për pensionistët, për invalidët, të cilët përbëjnë rreth 25% të familjeve taksapaguese.

Taksapaguesit biznese dhe institucione:



Bazuar në regjistrat aktualë, në total numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën

e detyrimeve fiskale të Bashkisë është 1953 dhe 23 institucione.

Bashkia BIZNES	0-2MILION	2-5 MILION	5-8 MILION	8-14 MILION	14-50	mbi50	total
NJA Pogradec	868	165	91	48	51	93	1316
NJA Buchmas	209	35	14	13	15	24	310
NJA Udenisht	87	11	8	2	6	9	123
NJA Cerrave	62	6	7	4	2	10	91
NJA Dardhaz	22	2				1	25
NJA Proptisht	33	1	2	4	1	5	46
NJA Velcan	17	1				4	22
NJA Trebinje	11			1	8		20
TOTAL BIZNESE	1309	221	122	72	83	146	1953
INSTITUCIONE							23
TOTAL BIZNESE-INSTITUCIONE							1976

Lloji i Aktivitetit	mbi 50	14-50	xhiro 8-14	xhiro 5-8	xhiro 2-5	xhiro 0-2	Total
Agjensi Sigurimi	7	0	1	1	0	16	25
Bar-Kafe	0	0	0	10	17	193	220
Bar-Rest.-Hotel	0	9	12	14	27	90	152
Farmaci	0	0	0	0	0	2	2
Fondacion	0	0	0	0	0	0	0
Hotel	0	0	0	0	0	0	0
Magazine ushqimore	6	6	4	1	0	2	19
Magazine industriale	3	2	0	3	11	1	20
Nderim	6	1	6	4	3	17	37
Prodhim	11	7	1	5	30	66	120
Prodhim FARA E FIDAN	0	0	0	3	2	6	11
SHA	6	2	0	0	0	0	8
Sherblin	1	2	0	32	41	327	403
Tregeti	45	33	42	9	4	51	186
Ushq.Shumice	18	6	1	1	3	7	36
Ushq.Pahice	0	0	0	10	19	112	141
Industriale	0	0	0	6	20	151	177
Mish-Peshk-Balmet	0	0	0	1	1	23	25
Profesion i lire ing.arak.	0	0	0	10	22	43	77
Profesion i lire mjekesi.	0	0	1	10	15	27	53
Ambulant	0	0	0	0	0	0	0
Banka	13	0	0	0	0	0	13

SH.K.K	4	0	0	0	0	0	4
Kabllor	0	0	0	0	0	3	3
Koncesion	13	0	0	0	0	0	13
hidrocentral	1	8	1	0	0	0	10
Inerte	4	1	2	1	4	6	18
INSTITUCIONE	0	0	0	0	0	23	23
Televizion	0	0	0	0	0	0	0
Bujtina	0	0	0	0	0	2	2
SERVIS	0	0	1	1	2	33	37
PARUKERI	0	0	0	0	0	76	76
Byrektorë	0	0	0	0	0	17	17
karburant	8	4	0	0	0	0	12
Kabinët dentur me kontratë	0	0	0	0	0	13	13
total	146	83	72	122	221	1309	1953

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi, më poshtë ju njeh me parashikimin e të ardhurave për vitin 2026:

Të ardhurat nga burimet e veta vendore, përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifat vendore dhe të ardhurat nga taksat e ndara.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat në Bashkinë Pogradec, është mbështetur:

Në nivelet e aplikueshme të taksave dhe tarifave vendore të miratuara si në legjislacionin tatimor në fuqi, ashtu dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.133, datë 11.12.2023 për "Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec", i ndryshuar, të cilat përcaktojnë llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajojnë çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcaktojnë qartë edhe administrimin e tyre duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj. Në realizimet faktike të të ardhurave për periudhën paraardhëse dhe realizimin 11 mujor të vitit 2025.

Nëpër llogaritjet e kapaciteteve reale të taksave dhe tarifave nëpërmjet zgjerimit të bazës së taksapaguesve dhe saktësimit të të dhënave për të cilat janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, pronarë pasurish, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të taksave dhe tarifave sipas llojeve.

Në parashikimin e mbledhjes së detyrimeve debitore të 18 muajve të fundit, referuar legjislacionit në fuqi duke zbatuar me përpikmëri të gjitha hapat, procedurat dhe afatet e



parashikuara si dhe duke bashkëpunuar ngushtë me aktorët e tjerë për vijimësinë dhe efektivitetin e këtyre masave.

Në parashikimin e të ardhurave që mbledhen nga agjentët tatimorë duke kërkuar, rritur dhe forcuar më tepër kontrollin mbi ta por dhe mënyrën e rakordimit për taksat apo tarifatat që këta të fundit mbledhin për llogari të Bashkisë Pogradec.

Në parashikimin e të ardhurave që mbledhen nga drejtoritë e Bashkisë.

Në ecurinë e realizimit të të ardhurave për çdo taksë dhe tarifë si dhe duke analizuar faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.

Në forcimin e kapaciteteve administruese.

Në lehtësimin e procedurave dhe përmirësimin e klimës së marrëdhënieve me taksapaguesit.

Drejtoritë e Bashkisë, Institucionet dhe Agjentët Tatimorë janë strukturat kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave nga burimet e veta vendore të Bashkisë Pogradec.

Në mënyrë të detajuar po paraqesim planifikimin për vitin 2026, në lidhje me të ardhurat nga burimet e veta vendore.

Bashkia Pogradec, përbëhet nga qyteti dhe 7 Njësi Administrative: Buçimas, Çërravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht, Udënisht dhe Velçan.

Popullsia e bashkisë numëron rreth 91,936 banorë sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile dhe 32,195 Familje.

Numri i popullsisë në Qytet: 39,612 dhe Numri i Familjeve: 14,260.

Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Buçimas : 20,282 dhe numri i Familjeve: 6,638.

Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Çërravë: 9,445 dhe numri i Familjeve: 3,263.

Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Dardhas: 3,387 dhe numri i Familjeve: 1,209.

Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Udënisht: 7,724 dhe numri i Familjeve: 2,756.

Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Proptisht: 5,752 dhe numri i Familjeve: 2,856.

Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Trebinjë: 2,864 dhe numri i Familjeve: 996.

Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Velçan: 2,870 dhe numri i Familjeve: 1,035.

Në Bashkinë Pogradec për vitin 2026, parashikohen të arkëtohen 805,386,200 lekë, nga të ardhurat nga burimet e veta.

Taksat vendore zënë 54 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të mbledhen për vitin 2026.

Tarifat vendore zënë 33 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen për vitin 2026.

Tarifa të tjera (qira, gjoha, ndikimi në mjedis) zënë 3 % të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen për vitin 2025.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore planifikohet të mbledhë 52 % të parashikimit të planit. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit planifikon të mbledhë 44% të parashikimit.

Nga taksat e ndara planifikohet të arkëtohen 8.4 % të të ardhurave të parashikuara për t'u arkëtuar në vitin 2026.



Nga tarifat e tjera planifikohet të arkëtohen 2 % të të ardhurave të parashikuara për t'u arkëtuar në vitin 2026.

Nga të ardhurat e taksave vendore parashikohet të arkëtohen 433,453,200 lekë dhe konkretisht nga:

Taksa vendore mbi biznesin e vogël 400,000 lekë.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme parashikohet të arkëtohen 86,253,200 lekë nga:

Taksa mbi ndërtesën 78,000,000 lekë nga të cilat:

- 50,000,000 lekë nga taksa mbi ndërtesën për familje.
- 28,000,000 lekë nga taksa mbi ndërtesën biznes.

Taksa mbi tokën bujqësore pritët të arkëtohen 3,000,000 lekë.

Taksa mbi truallin pritët të arkëtohen 5,253,200 lekë:

- Taksa mbi truallin për familje 1,021,600 lekë.
- Taksa për truallin biznes 4,500,000 lekë.

Taksa vendore e shërbimit hotelier pritët të arkëtohet vlera 9,000,000 lekë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja parashikohet 330,000,000 lekë.

Taksa e tabelës planifikohet 7,800,000 lekë:

- 3,000,000 lekë Taksa e tabelës për qëllime identifikimi.
- 4,800,000 lekë Taksa e tabelës për qëllime reklamimi.

Nga të ardhurat e tarifave vendore parashikohet të arkëtohen 266,063,599 lekë dhe konkretisht nga:

Tarifa e Pastrimit parashikohet të arkëtohen 122,720,000 lekë:

- 63,000,000 lekë nga Tarifa e pastrimit për familjet.
- 720,000 lekë nga Tarifa e pastrimit për institucionet.
- 59,000,000 lekë nga Tarifa e pastrimit për biznesin

Tarifa për ndriçim publik parashikohet të arkëtohen 32,723,000 lekë.

- Tarifa për ndriçim publik nga familjet 25,000,000 lekë
- Tarifa për ndriçim publik nga institucionet 23,000 lekë
- Tarifa për ndriçim publik ngabizneset 7,700,000 lekë



Tarifa për gjelbërimin parashikohet 58,360,000 lekë.

- Tarifa për gjelbërimin nga familjet 30,000,000 lekë
- Tarifa për gjelbërimin nga institucionet 360,000lekë
- Tarifa për gjelbërimin nga bizneset 28,000,000lekë

Tarifë për mirëmbajtje varrezash 10,000,000 lekë.

Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë 42,260,000 lekë.

- Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë 1,700,000 lekë
- Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit 21,000,000 lekë.
- Tarifa e licensimit të veprimtarive të transportit 700,000 lekë.
- Tarifa për pyjet dhe kullotat 1,000,000 lekë.
- Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrfiksjë MNZ 760,000 lekë.
- Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike 15,000,000 lekë.
- Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore (telefoni, internet) 2,100,000 lekë.

Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës 12,000,000 lekë.

- Çerdhet dhe Kopshtet 9,000,000 lekë
-
- Ndërmarrja NMI 3,000,000 lekë.

Të ardhurat e tjera parashikohen në vlerën 26,170,000 lekë.

- Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë Pogradec 21,000,000 lekë.
- Kundërvajtjet administrative (Gjobat) 4,000,000 lekë.
- Të tjera (ndikimi në mjedis) 1,170,000 lekë.

Të ardhurat nga taksat e ndara përlllogaritet në vlerën 67,700,000 lekë.

- Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë përlllogaritet 4,500,000 lekë.
- Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorurapërlllogaritet 33,000,000 lekë.
- Renta Minerare 5% përlllogaritet 200,000 lekë.
- Tatimi mbi të Ardhurat Personale 2% përlllogaritet30,000,000 lekë.

Taksat dhe Tarifat Vendore:

Taksat Vendore



Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme parashikohet në vlerën 86,253,200 lekë.

TAKSA E NDËRTESES

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2026 planifikohet të jetë në vlerën 78,000,000 lekë dhe më specifikisht:

Në Njësinë Administrative Pogradec, për vitin 2026, planifikohet të arkëtohen nga taksa e ndërtesës 50,900,000lekë, konkretisht:

Në Njësinë Administrative Pogradec, planifikohet të arkëtohet vlera 17,400,000 lekë, për 1,442 njësi pronësore për qëllime biznesi me sipërfaqe 117,171 m², detajohet si më poshtë:

- 22,586 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore mbi 50 milion lekë.
- 13,664 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 14-50 milion lekë.
- 6,968 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 8-14 milion lekë.
- 8,949 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 5-8 milion lekë.
- 7,791 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 2-5 milion lekë.
- 57,213 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit apo individëve, të cilët zotërojnë njësi pronësore të destinuara për aktivitet social-ekonomik, si dhe nga njësitë pronësore në të cilat nuk ushtrohet aktivitet,pritet të arkëtohet vlera 1,589,234 lekë.

Nga familjarët e Bashkisë Pogradec planifikohet të arkëtohen 33,500,000 lekë për 1,033,196 m² sipërfaqe ndërtim e destinuar për banim.

Në Njësinë Administrative Velçan, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës me vlerë1,294,205 lekë, konkretisht:

Pritet të arkëtohet vlera prej 455,805 lekësh, nga subjektet aktive të cilat ushtrojnë aktivitet me sipërfaqe 3,127 m²:

- 1978 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 124 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 152m² sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 873 m² sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e ndërtesës pritet të arkëtohet vlera prej 186,197 lekësh.

Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 838,400 lekësh për një sipërfaqe totale prej 70,222 m².



Në Njësine Administrative Trebinjë nga taksa mbi ndërtesën pritet të arkëtohen 536,004 lekë dhe konkretisht:

Vlera prej 39,200 lekësh nga 595 m² sipërfaqe ndërtesë të subjekteve aktive që ushtrojnë aktivitet:

- 300 m² sipërfaqe ndërtesë për 4 biznese me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 295 m² sipërfaqe ndërtesë për 11 bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Për taksën e ndërtesës për familje në Njësine Administrative Trebinjë planifikohet të arkëtohet vlera prej 291,900 lekësh nga për një sipërfaqe totale prej 33,810 m².

Nga debitorët e subjekteve të biznesit në Njësine Administrative Trebinjë pritet të arkëtohet vlera prej 15,359 lekësh për taksën e ndërtesës.

Në Njësine Administrative Proptisht, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës me vlerë 1,208,523 konkretisht:

Pritet të arkëtohet vlera prej 203,523 lekësh nga 1104 m² sipërfaqe e 56 subjekteve aktive që ushtrojnë aktivitet:

- 60 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 100 m² sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 20 m² sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 924 m² sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit në Njësine Administrative Proptisht, në vitin 2026, pritet të arkëtohet vlera prej 142,005 lekësh.

Për Taksën e Ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 1,005,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 83,205 m².

Në Njësine Administrative Dardhas, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës me vlerë 637,000 lekë, konkretisht:

Pritet të arkëtohet vlera prej 196,000 lekësh nga subjektet aktive që ushtrojnë aktivitet në sipërfaqe totale 1678 m² dhe konkretisht:

- 286 m² sipërfaqe ndërtesë për 2 bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 1392 m² sipërfaqe ndërtesë për 22 bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit pritet të arkëtohet vlera prej 50,658 lekësh.

Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 441,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 50,980 m².

Në Njësine Administrative Çërravë, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës në vlerën 3,088,700 lekë, konkretisht:

Pritet të arkëtohet vlera prej 585,000 lekësh nga subjektet aktive që ushtrojnë aktivitet në sipërfaqe totale 6,577 m² dhe konkretisht:

- 1742 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 318 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 255 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 545 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 496 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 3221 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.



Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e ndërtesës pritet të arkëtohet vlera prej 248,580 lekësh.

Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 2,503,700 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 247,571 m².

Në Njësinë Administrative Udënisht planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës në vlerën 4,263,000lekë, konkretisht:

Vlera prej 2,343,000 lekësh nga subjektet aktive që ushtrojnë aktivitet në një sipërfaqe totale prej 16,669 m² dhe konkretisht:

- 1775 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 1235 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 900 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 3619 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 1195 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 7945 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e ndërtesës pritet të arkëtohet vlera prej 1,920,000 lekësh.

Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 2,000,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 146,944 m².

Në Njësinë Administrative Buçimas planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës në vlerën 16,277,472 lekë, konkretisht:

Vlera prej 6,777,472 lekësh nga subjektet aktive që ushtrojnë aktivitet në një sipërfaqe totale prej 47648 dhe konkretisht:

- 9,699 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 17,424 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 3,127 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 2,721 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 5,146 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 9,531 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e ndërtesës pritet të arkëtohet vlera prej 3,059,900 lekësh.

Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 9,500,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 468,497 m².

Efekti ekonomik i përjashtimeve për taksën mbi ndërtesën.

Në Njësinë Administrative Pogradec 14,167 familje kanë gjendjen civile, nga të cilat 11,500 familje janë rezidente.

Përjashtohen nga taksa e ndërtesës 409 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, 1,541 familje pensionistësh, si dhe 748 familje me kryefamiljarë të vetmuar.



Në Njësinë Administrative Velçan 1,035 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, 785 familje janë rezidente.

209 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje me pensionistë përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Trebinjë, 996 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, 512 familje janë rezidente.

210 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje me pensionistë përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Proptisht 2,038 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, 1,000 familje janë rezidente.

395 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje me pensionistë përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Dardhas 1209 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile 638 familje janë rezidente.

194 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje pensionistësh përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Çërravë, 3263 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile 2,500 familje janë rezidente.

559 familje trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje pensionistësh përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Udënisht, 2756 familje kanë gjendjen civile dhe 2,000 familje janë rezidente, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile.

372 familje trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje pensionistësh përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Buçimas, 6638 familje kanë gjendjen civile dhe 4539 familje janë rezidente, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile.

451 familje trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 431 familje pensionistësh përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

TAKSA MBI TRUALLIN

Taksa mbi truallin për vitin 2026 planifikohet të jetë në vlerën 5,253,200 lekë.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m², në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.



Bashkitë ndodhen në mungesë të bazës së të dhënave për këtë taksë si dhe në pritje të akteve ligjore plotësuese për taksimin e truallit, si një taksë qendrore për t'u aplikuar nga njësitë vendore dhe si rrjedhim, planifikimi bazohet në të dhëna historike dhe trendin vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit.

Kjo taksë planifikohet të arkëtohet:

Në Njësinë Administrative Pogradec, për vitin 2026, planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e truallit vlera prej 2,609,915 lekë, nga të cilat:

Njësi pronësore biznese me 108,032 m² sipërfaqe truall dhe vlerë prej 2,107,580 lekësh nga:

- 16,366 m² sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore mbi 50 milion lekë.
- 10,006 m² sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore 14-50 milion lekë.
- 5,078 m² sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore 8-14 milion lekë.
- 12,329 m² sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore 5-8 milion lekë.
- 6,909 m² sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore 2-5 milion lekë.
